



3020
Z. Xhafa
[Signature]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. 4053/prot.

Tiranë, më 09.09.2024

Lënda: Kthim përgjigje lidhur me “Kërkesë për bashkëpunim dhe angazhim”

Z. FATMIR XHAFA
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM PARLAMENTAR
“Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe anti korrupsionin për
Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian”
KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 4, Tiranë”

Për dijëni:

Z. GENCI GJONÇAJ
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM ✓
KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

I nderuar z. XHAFA,

Në emër të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ju falenderojmë për kërkesën tuaj për bashkëpunim dhe angazhim në kuadër të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian”.

Këshillit e vlerëson këtë kërkesë si një mundësi të mirë për intensifikimin e mëtejshëm jo vetëm të bashkëpunimit ndërinstitucional, por mbi të gjitha për fuqizimin dhe intensifikimin e përpjekjeve të përbashkëta për forcimin e sundimit të ligjit në vend. Gjatë veprimtarisë së tij, Këshilli i ka konsideruar çështjet e integritetit evropian si çështje prioritare duke dëshmuar përkushtim maksimal për të adresuar në kohë dhe me cilësi rekomandimet e strukturave të Bashkimit Evropian, në përgjigje të përmbushjes edhe të Rezolutës së Kuvendit.

Në vijim të këtyre përpjekjeve, sikurse jeni në dijeni, Këshilli ka depozituar në Kuvend një seri propozimesh për ndryshime ligjore të njohura si “Paketa për funksionalitetin e sistemit gjyqësor” dhe “Paketa për reduktimin e stokut të çështjeve të prapa mbetura”. Këto propozime synojnë ndërmarrjen e reformave të rëndësishme që shënjestrojnë posaçërisht rekomandimet e propozuara nga strukturat e BE-së në kuadër të procesit të negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në familjen Evropiane, të cilat janë në pritje të një reagimi nga ana e Kuvendit.

Nën këtë këndvështrim, Këshilli shpreh angazhimin maksimal për të kontribuar përmes propozimeve dhe opinioneve lidhur me ndryshime në legjislacionin në fuqi, në ushtrim të plotë të kompetencave ligjore përcaktuar në nenin 93 të Ligjit nr. 115/2016, i ndryshuar, krahas ofrimit të një analize gjithëpërfshirëse të situatës në sistemin gjyqësor dhe problematikave të saj post zbatimit të Reformës në Drejtësi.

Duke vlerësuar parimin kushtetues të ndarjes dhe balancimit të pushteteve mbi të cilën ka mbështetur veprimtarinë e tij Komisioni i Posaçëm Parlamentar, ju bëjme me dije se, pika e kontaktit nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të shkëmbyer informacione lidhur për sa më sipër është znj. Baisa Sefa, me detyrë Drejtore Kabineti (baisa.sefa@klgj.al).

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Me konsideratë,

KRYETARE
NAUREDA LLAGAMI

